



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Dr./No 01/50 Nr. i faq./Br.str./No.pg 78

Data/Date: 29.4.2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 53 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 14 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 6 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Propozimit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 02.5713 të datës 30.04.2025, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2024 merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 31/25 i datës 28.03.2025 për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 31/25 i datës 28.03.2025 për dhënien e pëlqimit paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.
2. Pika 2 e vendimit bazik ndryshohet dhe formulohet me tekstin si në vijim:
 - 2.1. Pronat e paluajtshme për dhënien në shfrytëzim të cekura në pikën 1 të këtij vendimi janë:
 - 2.1.1. Pjesa e parcelës në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur bavan-bavan, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-01315-0 në sipërfaqe prej 2016m² (dymijë e gjashtëmbëdhjetë metra katror) duke përfshirë edhe objektin e Hotelit "Park Plaza", e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2803m² (dymijë e tetëqind e tre metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.1.2. Parcela në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur qytet, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-01318-2 në sipërfaqe prej 969m² (nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
3. Ndërsa pikët tjera të vendimit bazik me Nr. Prot. 01 Nr. 31/25 i datës 28.03.2025 mbesin të pandryshuara.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për

Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.50/25

Datë:29.04.2025


Arbër Zenuni
Kryesues i Kuvendit